Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Enver Bytyçi	**11.12.2023**	**23.12.2023**	**2023/0991**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.12.2023, OE "Zyra e Avokatise Blerim Mazreku SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0991, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Avokat Flaka Gutaj B.T"- Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ofrimi i sherbimeve ligjore per Komunen e Prizrenit" me nr. të prokurimit: "622-23-10590-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Kontrate Publike Kornize shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0991 i dt:08.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji i Prokurimit Publik

- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 67 – Provat shkresore
- Neni 68 - Gjendja Ekonomike dhe Financiare
- Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Ligji për Avokatinë

- Neni 10 – Kushtet për regjistrim
- Neni 22 - E drejta e pagesës dhe pengut
- Neni 39 – Humbja e të drejtës për ushtrimin e avokatisë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

1.1. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit (Tutje referuar si: "**Autoriteti Kontraktues**") me datën 03.10.2023 ka hapur aktivitetin e prokurimit me numër

622-23-10590-2-2-1 dhe me titull: "*Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit*".

1.2. Në këtë aktivitet të prokurimit kriteret kryesore për dhënien e kontratës ishin: 1. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare "*Dështmi se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (2020. 2021. 2022) ka qen prej jo më pak se 50.000,00 Euro*", 2. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale "*Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te njoftimit) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës (shërbime) duhet të jetë jo ma e vogël se 30.000,00 €. Kërkesa 2 - Në kuadër të stafit profesional OE duhet të ketë në përbërje të stafit së paku edhe Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës. Dhe për shkak të natyrës së lëndëve të cilat janë shumica e natyrës civile Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë të dhënë provimin e jurispodencës dhe me gradë shkencore Doktorr i shkencave civile*."

1.3. Brenda afatit të paparë me dosjen e tenderit Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K. (Tutje referuar si: "**Ankuesi**") ka dorëzuar ofertën me të gjitha dokumentet mbështetëse siç janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

1.4. Me datë 20.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Dokumentin B58 Njoftimin për Vendimin e Autoritetit Kontraktues (Tutje referuar si: "**Vendimi i Kontestuar**") me të cilin kemi kuptuar se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik Avokat Flaka Gutaj BI, përkundër se e njëjta nuk i përmbush kriteret e dosjes së tenderit. Ankuesi brenda afatit ligjor, ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim me të cilën ka arsyetuar se oferta e operatorit ekonomik Avokat Flaka Gutaj BI është e papërgjegjshme për arsyet si në vijim:

a. Nuk përmbush kriterin në lidhje me mundësitë teknike dhe profesionale për qarkullim specifik të natyrës së kontratës në vlerë prej 30,000.00 Euro;
b. Oferta ka gabime aritmetike që tejkalojnë kufizimin prej 2 përqind;
c. Ka paraqitur kontrata pune me avokat të licencuar në kundërshtim me Ligjin për Avokatinë (kontratë e palejuar).

1.5. Autoriteti Kontratkues me datë 29.11.2023 ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim si kinse të pabazuar dhe me një arsyetim të përgjithësuar, pa asnjë referencë në dispozita ligjore. Duke mbetur i pakënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Ankuesi i drejtorhet Organit Shqyrtues të Prokurimit me këtë Ankesë, për të kërkuar eliminimin e shkeljeve ligjore, të cilat do të elaborohen si më poshtë.

II. OFERTA E OPERATORIT TË REKOMANDUAR NUK PËRMBUSH KËRKESAT E QARKULLIMIT SPECIFIK TË NATYRËS SË KONTRATËS

2.1. Në dosjen e tenderit është kërkuar "*Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës (shërbime) duhet të jetë jo ma e vogël se 30.000,00 €.*" Nga qasja në dokumente kemi vërejtur se e rekomanduara për dhënie të kontratës nuk e plotëson këtë kriter,

pasi që nuk ka asnjë kontratë të ngjashme të realizuar, nuk ka dorëzuar listë të projekteve të ngjashme dhe se të gjitha kontratat që pretendon se i ka realizuar, i ka me bashkëshortin e saj i cili po ashtu ka kompani të avokatisë. Pra e rekomanduara nuk ka kontrata me klient, por ka kontratë bashkëpunimi dhe ka punuar për bashkëshortin e saj, dhe në këtë formë nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që nuk ka dëshmuar kapacitet në fushën e kërkuar sipas natyrës së kontratës. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar këtë pretendim pa ofruar asnjë arsyetim se si ka ardhur deri tek përfundimi se e njëjta i ka plotësuar këto kërkesa të Dosjes së Tenderit.

2.2. Një kontratë e një avokati, i cili i ka ofruar shërbime avokatit tjetër (burrit të saj) nuk konsiderohet si kontratë e vlefshme për të përmbushur kriterin e dosjes së tenderit. Së pari në kontratë nuk janë specifikuar cilat shërbime me saktësi janë ofruar, me çfarë çmime për njësi dhe në cilën periudhë kohore. Këto marrëveshje nuk përmbushin as një kriter minimial për tu konsideruar si të besueshme për Autoritetin Kontraktues. Të dy kontratat kinse nga 30,000 Euro janë të vitit 2022 deri në vitin 2023. Nga vet përshkrimi i pagesave, sipas dëshmive bankare të dorëzuara nga vet e rekomanduara, shihet se këto mjete nuk janë transferuar si pagesa të faturave, por transfer i shpenzimeve. Autoriteti kontraktues është dashur së paku të kërkoj faturat dhe pagesat, për të pranuar si të vlefshme këto kontrata. Rrjedhimisht, në rastin konkret pagesat duhet të ishin dëshmuar me pagesë të faturave, siç kërkohet në dispozitat e Ligjit për Avokatinë, Nenin 22 (2) në të cilin thuhet: "*Avokati është i detyruar t'ia jap palëve faturën për shërbimet e kryera dhe shpenzimet e paguara*".

2.3. E rekomanduara për kontratë nuk e ka përmbushur as kërkesën tjetër që ishte për dorëzimin e listën e kontratave të ngjashme me titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Ajo vetëm ka dorëzuar një Excel file me numra të lëndëve dhe emrat e palëve, por nuk ka kontrata, data të kontratave si dhe çka është më me rëndësi vlerat e këtyre kontratave. Nga lista e dorëzuar ajo shihet se është listë e klientëve për raste specifike dhe jo kontrata të ngjashme me këtë për të cilën ka aplikuar e rekomanduara për kontratë. Për këtë arsye Komuna e Prizrenit duhet ta eliminoj atë si të papërgjegjshme.

III. OFERTA E TË REKOMANDUARËS KA GABIME ARITMETIKORE MBI KUFIZIMIN LIGJOR

3.1. Nga qasja në dokumente tek e rekomanduara për kontratë, vërehet se në paramasë përkatësisht përshkrimin e çmimeve, e njëjta fare nuk ka kalkuluar një pozicion atë 3 dhe 3.1. Rrjedhimisht nga ky moskalkulim i një pozicioni oferta e së njëjtës është klasifikuar si më e lirë. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, përkatësisht Nenit 59 (3) thuhet: "*Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla*." Në këtë rast vlera e këtij pozicioni ishte 60 Euro me TVSH dhe poentomi 9. Në këtë rast sipas dispozitës së

Ligjit të Prokurimit Publik, kjo ofertë ka qenë dashur të eliminohet si e papërgjegjshme pasi që ka gabim aritmetikor i cili kalon limitin prej 2 përqind të vlerës së ofertës.

3.2. Mos vërejtja e këtij gabimi aritmetikor nga ana e zyrtarëve për vlerësimin e ofertave është shkelje substanciale e Nenit 7 [Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi] në të cilën thuhet: "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*" Kjo për shkak se me të njëjtat çmime identike për pozicione në mes të Ankuesit dhe të rekomanduarës për kontratë, Autoriteti Kontraktues ka nxjerr vlerësim të gabuar dhe e ka listuar të rekomanduarën si kinse operator më të lirë. Në fakt kjo ofertë është dashur të eliminohet.

3.3. Në Vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues tenton që ti ikë përgjegjësisë për mos eliminimin e gabimit aritmetikor, duke tentuar të vëjë kinse përgjegjësinë mbi ankuesin.

IV. E REKOMANDUARA KA PARAQITUR KONTRATA PUNE ME AVOKAT TË LICENCUAR NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN PËR AVOKATINË (KONTRATË E PALEJUAR)

4.1. Në ofertën e vet e rekomanduara për dhënie të kontratës ka paraqitur gjithsej katër (4) punëtor, duke përfshirë edhe Muhamet Shalaj i cili siç vërehet nga ky dokument i është paguar tatimi vetëm për muajin e 9-të. Për të njëjtin nga dëshmitë bankare nuk shihet asnjë pagë e paguar, siç nuk shihen as paga për të punësuarit e tjerë të pretenduar për të cilët i ka deklaruar e rekomanduara. Së pari duhet theksuar se Muhamet Shalaj është avokat i licencuar, dhe të njëjtit nuk i lejohet krijimi i marrëdhënies së punës, pasi që krijimi i marrëdhënies së punës është element që ndikon në humbjen e licencës së avokatisë. Në Nenin 39 nënparagrafi 1.8 thuhet qartë se krijimi i marrëdhënies së punës nga ana e avokatit është bazë për humbje të licencës. I njëjti ka zyrën e vet të avokatisë me emër Muhamet Shalaj B.I. dhe me numër të biznesit 810058869.

4.2. Nga verifikimi i këtij personi në ATK del se i njëjti ka marrëdhënie primare të punës me një institucion publik dhe pranon pagë të plotë si dhe kryen punë me orar të plotë për çka paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe se paga me të rekomanduarën për kontratë është pagë sekondare. Nga kjo i bie se kjo kontratë me orarin në të cilin është paraqitur është mashtruese dhe se i njëjti nuk mund ta përmbushë atë, pasi që ka marrëdhënie pune me orare të plotë 08:00-16:00 pesë ditë në javë me një institucion publik shkollor. (shih si provë 1 të dhënat e ATK nga verifikimi i deklarimit të punëtorit).

4.3. Nga sa u theksua më sipër i bie se kontrata e tillë nuk duhet dhe nuk mund të pranohet si valide nga ana e Autoritetit Kontraktues, prandaj kjo ofertë duhet të eliminohet si e papërgjegjshme.

4.4. Për më tepër vet e rekomanduara për kontratë nuk gjindet fare në listën e të punësuarve të kompanisë dhe po ashtu as nuk ka të paguara tatim në të ardhurat personale dhe si e tillë fare nuk figuron në regjistrat e ATK-së si e punësuar. Kjo gjithashtu përbën shkelje serioze të Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale.

4.5. Në përgjithësi nga kjo ofertë duket qartë edhe nga të dhënat bankare se kjo kompani nuk ka klient, nuk ka të punësuar dhe nuk ka kapacitete për përfaqësimin e një institucioni kaq të madh siç është Komuna e Prizrenit dhe për këtë arsye nuk mund dhe nuk duhet ti besohet një përgjegjësi kaq e madhe. Autoriteti kontraktues duhet të marrë në konsideratë të gjitha këto pretendime dhe prova dhe këtë ofertë ta trajtoj si të papërgjegjshme.

Andaj, duke marrë në konsideratë të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara më lartë, me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që pas shqyrtimit të kësaj Kërkese për Rishqyrtim të nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e operatorit ekonomik Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku ShPK, me adresë në Rrugën Remzi Ademaj, Nr. 94, Prizren.

II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 20.11.2023 dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM.**

III. **DETYROHET** Autoriteti Kontraktues që në afat prej 10 ditësh, ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

IV. **LEJOHET** të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KRITERET PËR VLERËSIM

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	6.4	Përveç deklarates se shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon: a.Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situate e tillë nuk ekziston. c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit *[para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]* Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.	
		Kërkesat e përshtatshmërisë: **1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov.net**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar,**

			të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale:** **Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit n informatat për biznesin (kopje). Evidenca Certifikata e numrit fiskal Evidenca 3 Qertefika e TVSH së**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (2020. 2021. 2022) ka qen prej jo më pak se 50.000,00 €**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiar kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi finan nga banka për tri vitet e shkuara apo deklarat tatimeve vjetore të dorzuara në Administra Tatimore të Kosovës.**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës (shërbime) duhet të jetë jo ma e vogël se 30.000,00 €. Kërkesa 2 Në kuadër të stafit profesional OE duhet të ketë në përbërje të stafit së paku edhe Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës. Dhe për shkak të natyrës së lëndëve të cilat janë shumica e natyrës civile Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës dhe me gradë shkencore Doktorr i shkencave civile.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skan nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmu me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e shërbim dhe natyrën e tyre apo proces verbal te prani përfundimtar të shërbimeve. Dëshmia Çertifikatat përkatëse mbi kualifikimin e kërku origjinale ose të noterizuara në praninë e punësuarit, kontratat e punës ose të bashkëpuni me OE për projektin në fjalë.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Jane shkeputur vetem pikat e raportit qe kane te bejne me kerkesat e dosjes se tenderit:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E PRANUSHMËRISË

Dokumenti	AVOKAT FLAKA GUTAJ B.I. - Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K.	Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov.net	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë e pranushmërisë:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRISË PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	AVOKAT FLAKA GUTAJ B.I. - Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K.	Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë profesionale:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR GJENDJEN EKONOMIKE & FINANCIARE

Dokumenti	AVOKAT FLAKA GUTAJ B.I. - Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K.	Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (2020. 2021. 2022) ka qen prej jo më pak se 50.000,00 €	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	AVOKAT FLAKA GUTAJ B.I. - Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit	SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K.	Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K.
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
Kërkesa 1 Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës (shërbime) duhet të jetë jo ma e vogël se 30.000,00 €. Kërkesa 2 Në kuadër të stafit profesional OE duhet të ketë në përbërje të stafit së paku edhe Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës. Dhe për shkak të natyrës së lëndëve të cilat janë shumica e natyrës civile Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës dhe me gradë shkencore Doktorr i shkencave civile.	Në pajtim	I papajtueshëm	Në pajtim

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

DËSHMITË LIDHUR ME KËRKESAT E PRANUESHMËRISË[2]

Emri i Tenderuesit te cilit Autoriteti Kontraktues ka ndërmend ndër mend që t'ia jap kontratën	Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë PO/JO			Është shpërblyer me kontrate PO/JO
	Certifikata nga Administrata Tatimore	Certifikata nga autoriteti kompetent gjyqësor apo administrativ	Kërkesa të tjera te pranushmërisë *(të specifikuara)*	
1. AVOKAT FLAKA GUTAJ B.I.	Po	Po		

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit: ISA OSMANKAJ

Nënshkrimi: _____

Data: 20.12.2023.

[2] Të kërkohet vetëm nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën.

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

15

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Me date 19.12.2023 Eksperti shqyrtues ka mbajtur takimin me ZPP te AK ne lidhje me sqarimin e paramases dhe parallogarise. Ne takim eshte diskutuar ne lidhje me pershkrimin e cmimeve dhe eksperti konsideron se AK gjate hartimit te paramases - pershkrimit te cmimit ka leshuar gabime te cilat kane shkaktuar konfuzion dhe paqartesi tek OE ofertues, ku te gjithe ofertuesit plotesimin e paramases e kane te plotesuar ne menyra te ndryshme.

AK ka vendosur 3 pozicione te cilat jane te pershkruara me nenpozicione. Pozicionit 3 i ka dhene sasi, duke i krijuar paqartesite dhe se OE kane dhene cmime ne kete pozicion duke e ngaterruar me nenpozicion. Cmimet duhet te jepen vetem ne nenpozicionet e paraqitura dhe pastaj nenpozicionet mbledhen tek totali i pozicioneve.

Ne kete aspekt AK ka krijuar konfuzion ne plotesimin e paramases dhe parallogarise.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Neni 4.1.26 LPP - plotesohet

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K.**

Sqarim Hyrës:

Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT ka udhëhequr aktivitetin e Prokurimit "Ofrimi i shërbimeve ligjore për Komunën e Prizrenit" me nr. të prokurimit: "622-23-10590-2-2-1" .

Me datë 02.10.2023 është publikuar njoftimi për kontratë;

Me datë 23.10.2023 afati për dorëzimin e ofertave;

Me datë 20.11.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK-së- B58;

Me datë 24.11.2023 OE i pakënaqur ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK

Me datë 29.11.2023 AK ka nxjerrë vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e paraqitur nga OE

Me datë 08.12.2023 OE ka paraqitur ankesë pranë OSHP me pretendimet ankimore;

Me datë 11.12.2023 OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues për vlerësimin dhe shqyrtimin e ankesës së OE ankues.

Eksperti shqyrtues sipas autorizimit të datës 11.12.2023 në pajtim me LPP, ka shqyrtuar lëndën dhe pretendimet ankimore të OE ankues.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues në pretendimin ankimor 1 ka mospajtime duke vlerësuar se OE fitues nuk e plotëson kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional pika 1. OE ankues ka paraqitur se OE i suksesshëm nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit dhe nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme sipas kërkesës së dosjes së tenderit duke thënë se: 2.1 OE fitues nuk ka dorëzuar listën e kontratave të realizuara dhe te gjitha kontrata i ka te lidhura me bashkëshortin e saj; 2.2 ka ofruar një kontratë për shërbime të cilën OE ankues e ka konsideruar jo të vlefshme duke përshkruar se AK është dashur së paku të kërkoj faturat dhe pagesat për ti konsideruar si të vlefshme; 2.3 OE fitues nuk i ka dorëzuar listën sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Përgjigje në pretendimin 1

Kërkesa e dosjes së tenderit tek dëshmitë e kërkuara potencon se :**Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të shërbimeve.**

Eksperti konsideron se mungon lista e projekteve dhe referencat andaj AK në funksion të plotë të LPP dhe legjislacionit sekondar, sipas Udhëzuesit Nr.001/2023 për prokurim publik, konform nenit 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, rasti kur mungon lista e kontratave apo referencat, AK duhet të kërkoj informata sqaruese sipas nenit 69 të LPP.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 1 është pjesërisht i bazuar dhe se AK duhet të kërkojë informata sqaruese.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se Oferta fituese ka gabime aritmetikore mbi kufizimin ligjor, duke shpjeguar se OE nuk ka kalkuluar një pozicion dhe se dallimi i këtij pozicioni është mbi vlerën e përcaktuar me ligj dhe se oferta duhet të eliminohet.

Përgjigje në pretendimin 2

Eksperti gjatë shqyrtimit të dokumentve të dosjes dhe krahasimit të tyre në mes OE ofertues jep sqarimin se:

AK ka hartuar paramasën dhe parallogarinë duke përfshirë tre(3) pozicione bazë, të cilat ndahen në disa nën pozicione.

Pozicioni bazë 1 përfshinë 4 nën pozicione të cilat janë: nën pozicionet 1.1,1.2,1.3,1.4

Pozicioni bazë 2 përfshinë po ashtu 4 nën pozicione të cilat janë 2.1,2.2,2.3,2.4

Pozicioni bazë 3 përfshinë vetëm një (1) nënpozicion 3.1

AK gjatë përgatitjes ka vendosur sasi edhe tek pozicionet bazë për të cilat nuk duhet vendosur sasi sepse ato janë rekapitullim i nën pozicioneve. Në këtë mënyrë AK ka krijuar konfuzion tek OE ofertues në plotësimin e përshkrimit të çmimit.

Për shkak të këtyre gabimeve OE ofertues nuk e kanë plotësuar si duhet Paramasën dhe parallogarinë e projektit:

Njëri ofertues ka dhenë çmim tek pozicioni 3 e nuk ka dhen çmim tek nën pozicioni 3.1 , ku në këtë rast oferta është e papërgjegjshme sepse ka gabime,

Ofertuesi fitues ka dhënë çmime tek të dy pikat edhe tek pozicioni 3 edhe tek nën pozicioni 3.1 ndërsa në rekapitullim nuk dihet se cila vlerë është marrë për bazë. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me gabime dhe oferta duhet të shpallet e papërgjegjshme.

OE ankues gjatë plotësimit të çmimit, ka dhënë çmim në pozicionin 3 dhe në nën pozicionin 3.1 dhe të njëjtat i ka mbledhur dhe i ka paraqitur tek çmimi total i pozicionit 3, këtu është e plotësuar gabim paramasa pasi që është mbledhur pozicioni 3 me nën pozicionin 3.1 dhe si ofertë për shkak të gabimeve duhet të shpallet e papërgjegjshme.

Tek pozicioni 3 përqindja e poentimit është paraqitur 15%.

Po ashtu edhe tek nën pozicioni 3.1 përqindja e realizimit është 15% që sipas AK nënkupton se ky pozicion nuk do të realizohen 100%, por 15 % brenda pozicionit 3. Nën pozicioni 3.1 meqenëse është i vetmi në pozicionin bazë 3, atëherë përqindja e poentimit brenda pozicionit duhet të jetë 100%.

Shih foton Paramasa e DT:

Paramasat me çmimin e peshuar për shërbimet juridike në Komunën e Prizrenit

Paramasa					
Nr.	Pershkrimi	Sasia	Perqindja e peshimit brenda pozicionit	Cmimi per njesi me TVSH	Poentimi brenda pozicionit
1	**Perpilimi i parashtresave ne proceduren civile dhe procedurat tjera**	**30%**			
1.1	Kontest i vleres se vogel	1	5%		0
1.2	Kontest me vlere mbi kontestin e vleres se vogel e deri ne 10,000 euro	1	15%		0
1.3	Kontest me vlere prej 10,000 euro e me larte	1	30%		0
1.4	Kontesti me vlere prej 100,000 euro e me larte	1	50%		0
	Cmimi total i pozicionit 1				0
2	Perfaqesimi ne seancat per qeshtje civile dhe te tjera	1	55%		
2.1	Perfaqesimi ne konteste te vleres se vogel	1	5%		0
2.2	perfaqesimi ne konteste qe vlera e kontestit mbi vleren e kontestit te vogel e deri ne 10,100 euro	1	15%		0
2.3	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 10,000 euro e me larte	1	30%		0
2.4	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 100,000 euro e me larte	1	50%		0
	Cmimi total i pozicionit 2				0
3	Mjetet juridike ne qeshtjet civile	1	15%		0
3.1	Mjetet	1	15%		
	Cmimi total I pozicionit 3				

RIKAPITULLIMI				
Tabelat		**Pesha në bazë të rëndësisë**	**Çmimi i pa Peshuar**	**Çmimi i Peshuar në përqindje**
1	**Pozicioni 1**	30%	0.00	
2	**Pozicioni 2**	55%	0.00	
3	**Pozicioni 3**	15%	0.00	
	Totali	100%	0.00	

Ofertat e dorezuara:

Paramasa					
Nr.	Pershkrimi	Sasia	Perqindja e peshimit brenda pozicionit	Cmimi per njesi me TVSH	Poentimi brenda pozicionit
1	Perpilimi i parashtresave ne proceduren civile dhe procedurat tjera	30%			
1.1	Kontest i vleres se vogel	1	5%	47.2	2.36
1.2	Kontest me vlere mbi kontestin e vleres se vogel e deri ne 10,000 euro	1	15%	118	17.7
1.3	Kontest me vlere prej 10,000 euro e me larte	1	30%	177	53.1
1.4	Kontesti me vlere prej 100,000 euro e me larte	1	50%	194.7	97.35
	Cmimi total i pozicionit 1			[redacted]	170.51
2	Perfaqesimi ne seancat per qeshtje civile dhe te tjera	1	55%		
2.1	Perfaqesimi ne konteste te vleres se vogel	1	5%	60.18	3.009
2.2	perfaqesimi ne konteste qe vlera e kontestit mbi vleren e kontestit te vogel e deri ne 10,100 euro	1	15%	82.6	12.39
2.3	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 10,000 euro e me larte	1	30%	165.2	49.56
2.4	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 100,000 euro e me larte	1	50%	250.16	125.08
	Cmimi total i pozicionit 2			[redacted]	190.039
3	Mjetet juridike ne qeshtjet civile	1	15%	118	17.7
3.1	Mjetet	1	15%	[redacted]	[redacted]
	Cmimi total i pozicionit 3			[redacted]	[redacted]

RIKAPITULLIMI				
Tabelat		Pesha në bazë të rëndësisë	Çmimi i pa Peshuar	Çmimi i Peshuar në përqindje
1	Pozicioni 1	30%	170.51	51.16 €
2	Pozicioni 2	55%	190.04	104.53 €
3	Pozicioni 3	15%	17.70	2.66 €
	Totali	100%	378.25	158.35 €

OE "SELIMAJ Legal Consulting SH.P.K."

Paramasat me çmimin e peshuar për shërbimet juridike në Komunën e Prizrenit

Paramasa					
Nr.	Pershkrimi	Sasia	Perqindja e peshimit brenda pozicionit	Cmimi per njesi me TVSH	Poentimi brenda pozicionit
1	Perpilimi i parashtresave ne proceduren civile dhe procedurat tjera	30%			
1.1	Kontest i vleres se vogel	1	5%	39	1.95
1.2	Kontest me vlere mbi kontestin e vleres se vogel e deri ne 10,000 euro	1	15%	52	7.8
1.3	Kontest me vlere prej 10,000 euro e me larte	1	30%	104	31.2
1.4	Kontesti me vlere prej 100,000 euro e me larte	1	50%	162.5	81.25
	Cmimi total i pozicionit 1			357.5	122.2
2	Perfaqesimi ne seancat per qeshtje civile dhe te tjera	1	55%		
2.1	Perfaqesimi ne konteste te vleres se vogel	1	5%	50.7	2.54
2.2	perfaqesimi ne konteste qe vlera e kontestit mbi vleren e kontestit te vogel e deri ne 10,100 euro	1	15%	67.6	10.14
2.3	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 10,000 euro e me larte	1	30%	135.2	40.56
2.4	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 100,000 euro e me larte	1	50%	211.25	105.63
	Cmimi total i pozicionit 2			464.75	158.86
3	Mjetet juridike ne qeshtjet civile	1	15%	60	9
3.1	Mjetet	1	15%	60	9
	Cmimi total i pozicionit 3				

RIKAPITULIMI				
Tabelat		Pesha në bazë të rëndësisë	Çmimi i pa Peshuar	Çmimi i Peshuar në përqindje
1	Pozicioni 1	30%	357.50	107.25 €
2	Pozicioni 2	55%	464.75	255.61 €
3	Pozicioni 3	15%	60.00	9.00 €
	Totali	100%	882.25	371.86 €

F. G.

AVOKATE
Flaka Gutaj
045 679 846
Rr. De Rada nr. 4 • Prizren

OE " Avokate Flaka Gutaj"

Paramasat me çmimin e peshuar për shërbimet juridike në Komunën e Prizrenit

Paramasa					
Nr.	Pershkrimi	Sasia	Perqindja e peshimit brenda pozicionit	Cmimi per njesi me TVSH	Poentimi brenda pozicionit
1	**Perpilimi i parashtresave ne proceduren civile dhe procedurat tjera**	**30%**			
1.1	Kontest i vleres se vogel	1	5%	39	1.95
1.2	Kontest me vlere mbi kontestin e vleres se vogel e deri ne 10,000 euro	1	15%	52	7.8
1.3	Kontest me vlere prej 10,000 euro e me larte	1	30%	104	31.2
1.4	Kontesti me vlere prej 100,000 euro e me larte	1	50%	162.5	81.25
	Cmimi total i pozicionit 1			357.50	122.20
2	Perfaqesimi ne seancat per qeshtje civile dhe te tjera	1	55%		
2.1	Perfaqesimi ne konteste te vleres se vogel	1	5%	50.7	2.54
2.2	perfaqesimi ne konteste qe vlera e kontestit mbi vleren e kontestit te vogel e deri ne 10,100 euro	1	15%	67.6	10.14
2.3	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 10,000 euro e me larte	1	30%	135.2	40.56
2.4	Perfaqesimi ne kontestet me vlere mbi 100,000 euro e me larte	1	50%	211.25	105.63
	Cmimi total i pozicionit 2			464.75	158.86
3	Mjetet juridike ne qeshtjet civile	1	15%	60	9
3.1	Mjetet	1	15%	60	9
	Cmimi total I pozicionit 3			120.00	18.00

RIKAPITULLIMI				
	Tabelat	**Pesha në bazë të rëndësisë**	**Çmimi i pa Peshuar**	**Çmimi i Peshuar në përqindje**
1	**Pozicioni 1**	30%	357.50	107.25 l
2	**Pozicioni 2**	55%	464.75	255.61 l
3	**Pozicioni 3**	15%	120.00	18.00 l
	Totali	100%	942.25	380.86 l

OE "Zyra e Avokatise Blerim Mazreku SH.P.K"

Sipas sqarimeve OE ofertues është dashur të japin çmime vetëm tek nën pozicionet dhe pastaj ato të mblidhen dhe të paraqiten tek totali i çmimit për pozicion dhe të njëjtat ti nënshtrohen formulës së peshimit tek rekapitullimi.

Sipas konstatimeve të mësipërme eksperti konsideron aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet dhe AK në procesin e ri tenderimit t'i bëjë përmirësimet e duhura në paramasën dhe parallogarinë e procedurës në DT.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi është i bazuar, mirëpo sipas sqarimeve të mësipërme asnjëri nga OE ofertues nuk është i përgjegjshëm për shkak të gabimeve në

paramasën dhe parallogarinë e përgatitur nga AK.

Pretendimi Ankimor 3

OE ankues e konteston stafin e paraqitur nga OE fitues duke aluduar se ka lidhur kontrata ne kundërshtim me ligjin për avokatinë dhe se personi i paraqitur ne listën e stafit është ne marrëdhënie pune primare me një institucion publik dhe pranon pagë të plotë me orar të plotë. Dhe se sipas OE ankues në bazë të verifikimeve del se OE fitues nuk ka klient, nuk ka të punësuar dhe nuk ka kapacitetet për përfaqësim të një institucioni.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

Eksperti shqyrtues pas verifikimit te dokumenteve konsideron se kërkesa 2 e dosjes së tenderit:

Kërkesa 2 *Në kuadër të stafit profesional OE duhet të ketë në përbërje të stafit së paku edhe Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës. Dhe për shkak të natyrës së lëndëve të cilat janë shumica e natyrës civile, Një (1) jurist të diplomuar i cili duhet të ketë ë dhënë provimin e jurispodencës dhe me gradë shkencore Doktorr i shkencave civile.*

Dëshmia 2 *Çertifikatat përkatëse mbi kualifikimin e kërkuar. origjinale ose të noterizuara në praninë e të punësuarit, kontratat e punës ose të bashkëpunimit me OE për projektin në fjalë.*

Sipas përshkrimit të DT OE ka ofruar dokumentet e nevojshme duke i plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, si dhe në këtë fazë nuk mund të paragjykohet se si do të angazhohet stafi i paraqitur, kështu që secili person i paraqitur ne cilësinë e stafit të OE merr përgjegjësitë në lidhje me deklarimet. I mbetet AK që gjatë realizimit të kontratës të menaxhoj dhe përcjellë angazhimin e stafit të ofruar në dosje të tenderit dhe të menaxhoj kontratën dhe realizimin e shërbimeve konform ligjeve në fuqi. Për raste të tilla të pretendimeve ankimore OSHP ka edhe vendime të lëshuara. (vendimi OSHP 2023/0495 pika ankimore 1).

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 3 është i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjeserisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe

Eksperti i rekomandon panelit shqyrtues që Aktiviteti i Prokurimit të anulohet në tërësi pasi që ka gabime thelbësore në paramasën dhe parallogarinë e dosjes se tenderit.

AK për shkak të gabimeve të bëra në paramasë dhe parallogari e ka pamundësuar vazhdimin e metutjeshem te procedures pasi qe nuk ka qartësi në dhënien e cmimit dhe nxjerrjen e totalit te cmimeve. Si pasojë e kësaj të gjithë OE ofertues e kanë plotësuar në mënyra të ndryshme dhe asnjëri nga OE nuk ka dhene cmime konform pershkrimeve ne paramase.

AK gjate Ri tenderimit duhet te permiresoj gabimet e leshuara ne paramasen dhe parallogarine e DT.

Shenim: Per aktivitetin e prokurimit ka pasur edhe nje ankese tjeter dhe eshte dhene ekspertiza me nr. 2023-974.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Zyra e Avokatisë Blerim Mazreku SH.P.K.**

Enver Bytyçi